

fshatit fqinj të Rakocit/Rakovac. E kishin qëlluar me një plumb në kokë. Sytë i kishte të lidhur. Pranë saj gjendej një gastare me benzinë, ndërkaq trupi i ishte mbuluar me dru të çara djegie. Zëvendëskomandanti i Shtabit të UÇK-së për Dukagjin/Dukadin, Nazmi Brahimaj, ka shënuar në ditarin e vet të luftës se “fshatarët supozojnë se Afërditën e kishte vrrarë togeri Idriz.” Familjarët e kanë varrosur Afërditën në varrezat e Pejës/Peç.

**Burimet:** deklarata S.G, FDH-31939; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6.D00127, FDH-31209.

### Sadedin (Hysen) Shehu

(16.02.1958, shqiptar nga Gjakovë/Đakovica, punëtor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Sadedini punonte në ndërmarrjen *Dukagjin* në Gjakovë/Đakovica deri në vitin 1991. Më pas, me bashkëshorten dhe fëmijët shkuan në Belgjikë, e pastaj në Gjermani. Në muajin qershor të vitit 1998, Sadedini u kthye nga Gjermania dhe u inkuadrua menjëherë në UÇK-në e fshatit Gillogjan/Glodane. Së bashku me katër pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, më **19.11.1998**, Sadedini tentoi të kalonte matanë kufirit me Shqipërinë, te vendi i quajtur *Bokat e Devës/Devin kamenjar [Devë/Deva]*. Por, aty ranë në një fushë të minuar. Sadedini i mori plagët vdekjeprurëse dhe ndërroi jetë menjëherë, ndërkaq të tjerë vetëm u plagosën. Trupi i tij nuk është gjetur kurrë. Në listën e të zhdukurve të administruar nga KNKK-ja, rasti i tij është evidentuar me numrin rendor BLG-804729-01.

**Burimet:** deklarata V.K, FDH-30764; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Agim (Sadri) Ibrahimimi

(7.06.1950, shqiptar nga Gjakovë/Đakovica, komuna e Gjakovës/Đakovica, taksist, tre fëmijë)

Agimin e kanë arrestuar në muajin gusht të vitit 1998, me dyshim se ishte pjesëtar i UÇK-së. I ka kaluar tetë ditë në qelinë e SPB-së në **Gjakovë/Đakovica**. E kishin rrahur brutalisht. Pas lirim, u rikuperua dhe ia nisi sërish nga puna. Në datën **20.11.1998**,

nga ora 15:00, Agimi shkoi në stacionin e taksive pranë stacionit të autobusëve në Gjakovë/Đakovica. Nga ajo ditë, askush nuk e kishte parë më kurrë. Fati i tij nuk është ndriçuar deri më sot. Në evidencën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Agimit është regjistruar në lëndën me numër BLG-804289-01.

**Burimet:** deklarata M.I, FDH-14383; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Isuf (Tahir) Olluri

(2.07.1959, shqiptar nga Rakovinë/Rakovina, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Isufi ishte i punësuar në hekurudhë. Nga viti 1983 deri në 1995, qarkullonte rregullisht në relacion Fushë Kosovë/Kosovo Polje - Prizren, kur u pushua nga puna. Pastaj, merrej me bujqësi. Në shtatorin e vitit 1996, policia serbe e ka kryer bastisjen e shtëpisë së familjes Olluri dhe e ka zbuluar një revole. Isufi me të vëllain Osmanin u dërguan në polici në Gjakovë/Đakovica, ku u keqtrajtuar me pretekst se e kishin të fshehur edhe pushkën. Në datën 20.04.1998, Isufi aderoi në radhët e UÇK-së. Gjatë kthimit nga Gjakovë/Đakovica më **25.11.1998**, Isufi ka rënë në pritë të policëve serb në **Rakovinë/Rakovina** dhe u qëllua për vdekje në vend.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-22449; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SMIP, *Terroristički...*, III, 570; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Driton (Halit) Zeqiri

(20.08.1988, shqiptar nga Nivokazi/Nivokaz, komuna e Gjakovës/Đakovica, nxënës)

Për shkak të sulmeve të shpeshta të forcave serbe, prindërit i kanë çuar jashtë fshatit Dritonin dhe motrën e tij Hidajeten, e cila ishte tre vjet më e vjetër nga ai. Të gjithë së bashku së pari u strehuan në Gjakovë/Đakovica, te Bujar Hoda. I ati Haliti kthehej në fshat gjithmonë kur luftimet pushonin. Në ato raste, fëmijët shkonin që ta vizitonin. Kështu ndodhi edhe më **8.12.1998**. Haliti gjendej në Nivokaz, ndërkaq fëmijët erdhën përmes Mulliqit/Molić për një vizitë. Pas tri